

SHTESË

Ndryshimet në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës

PJESA KRYESORE

Neni 1 Parimet e Përgjithshme

1.6 Shtim i një fjalie të re në fund: “Gjuhët Turke, Boshnjake dhe Rome do të kenë statusin e gjuhëve zyrtare në nivelin komunal apo do të jenë në përdorim zyrtar në përputhje me ligjin.”

Shtim i një Neni të ri 1.10: “1.10 Kosova dhe Republika e Serbisë inkurajohen që të themelojnë një komision të përbashkët për të lehtësuar një bashkëpunim të tillë, si dhe për të ndjekur dhe zhvilluar marrëdhënie të mira fqinjësore.”

Neni 4 Të Drejtat e Refugjatëve dhe Personave të Zhvendosur

4.1 Shtim i një fjalie të re në fund: “Çdo individ do të ketë të drejtë që të merr vendim të lirë dhe të informuar mbi vendit e tij/saj të kthimit.”

Neni 5 Personat e Zhdukur

5.2 Shtim i një fjalie të re të dytë: “Kryesuesi i Grupit Punues do të nxjerr raporte publike periodike mbi mbarëvajtjen e Grupit Punues.”

Neni 8 Çështjet Ekonomike dhe të Pronës

8.2 Zëvendësimi i “borxhit ndërkombëtar” me “borxh të jashtëm.”

Shtim i një neni të ri 8.5: “8.5 Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) do të vazhdojë të mbajë në besim asetet private për pensione dhe do t’i investojë ato asete në mënyrë të kujdesshme. Ai do të zbatojë funksionet e tij në mënyrë të pavarur. Bordi Qeverisës i TKPK-së do të ushtrojë detyrën e tij fiduciare vetëm në interes të përfituesve të tij.”

8.7 Shtim i një klauzole në fjalinë e parë (në italike): “Kosova dhe Republika e Serbisë *do të zhvillojë më tej lidhjet ekonomike mes tyre.*”

Neni 9 Sektori i Sigurisë

9.2 Shtimi i një klauzole në fund “në përputhje me Nenin 4.4 të Aneksit II të kësaj Zgjidhjeje.”

9.6 Zëvendësimi i “shpërbërjes” me “shuarje.” Ndryshim në afatin kohor për shuarjen e TMK-së nga një vit pas “hyrjes në fuqi të kësaj Zgjidhjeje” në brenda një viti nga “përfundimi i periudhës së tranzicionit siç përcaktohet me Nenin 15 të kësaj Zgjidhjeje.”

Neni 10 Komisioni Kushtetues

10.4 Ndryshime në kushtet e votimit për Kushtetutën nga “shumicë prej dy të tretash të pranishëm e që votojnë” në thjeshtë “shumicë prej dy të tretash.”

Heqja e Nenit të mëparshëm 10.5 mbi zgjedhjet nga Neni 10 mbi Komisionin Kushtetues në Nenin e ri 11.1.

Neni 11 Zgjedhjet

Shtimi i një Neni të ri vetëm mbi zgjedhjet, ku neni i mëparshëm 10.5 bëhet Nen i ri 11.1.

Shtim i një Neni të ri 11.2: “11.2 Të gjithë personat e moshës votuese në ditën e zgjedhjeve relevante, të cilët në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Zgjidhjeje janë të regjistruar si banorë të përhershëm, apo ata që banojnë jashtë Kosovës apo që e kanë braktisur Kosovën më apo pas 1 janarit të vitit 1998 dhe në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Zgjidhjeje i përmbushin kriteret për të qenë të regjistruar si banorë të përhershëm, do të kenë të drejtë të votojnë në ato zgjedhje në pajtim me ligjin në fuqi.”

Neni 15 Aranzhmanet Kalimtare dhe Dispozitat Përfundimtare

15.1 Shtim i një fjalie të re të dytë: “Gjatë periudhës së tranzicionit, KFOR-i do të vazhdojë të ushtrojë mandatin e tij në pajtim me rezolutën relevante të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.”

ANEKSI I DISPOZITAT KUSHTETUESE

Neni 1 Dispozitat Themelore

1.6 Fshirja e fjalës “fituar.”

Neni 2 Dispozitat për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut

2.3 Shtimi i një klauzole të re në fund: “të cilat do të jenë në mënyrë të drejtpërdrejtë të zbatueshme në Kosovë.”

Neni 3 Kuvendi i Kosovës

3.7 Ndryshim në procedurat e votimit të shumicës së dyfishtë që ka të bëjë me numrin e Deputetëve jo-shumicë që votojnë nga “shumica e Deputetëve që mbajnë ulëse të rezervuara apo të garantuara për përfaqësuesit e Komuniteteve që nuk janë në shumicë në Kosovë” në “shumica e Deputetëve të pranishëm dhe që votojnë që i përkasin partive, koalicioneve, iniciativave të qytetarëve dhe kandidatëve të pavarur që janë deklaruar se përfaqësojnë Komunitetet që nuk janë në shumicë në Kosovë siç përcaktohet me Nenin 3.2.”

Neni 5 Qeveria e Kosovës

Shtim i Nenit të ri 5.3: “5.3 Zgjedhja e atyre Ministrave dhe Zëvendës Ministrave do të përcaktohet pas konsultimeve me partitë, koalicionet apo grupet që përfaqësojnë Komunitetet që nuk janë në shumicë në Kosovë. Nëse të emëruarit nuk janë Deputetë të Kuvendit të Kosovës, ata Ministra dhe Zëvendës Ministra do të kërkojnë miratimin formal të shumicës së Deputetëve që i përkasin partive, koalicioneve, iniciativave të qytetarëve dhe kandidatëve të pavarur që janë deklaruar se përfaqësojnë Komunitetin në fjalë.”

Neni 7 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

7.1 Ndryshim në numrin total të anëtarësisë nga nëntë (9) në njëmbëdhjetë (11) anëtarë.

7.2 Ndryshim në numrin e anëtarëve të emëruar nga Deputetët që mbajnë ulëse të rezervuara apo të garantuara për Komunitetet tjera që nuk janë në shumicë në Kosovë nga një në (1) në tre (3).

Neni 8 Decentralizimi / Vetëqeverisja Lokale

8.4 Zëvendësimi i “kompetencave të zgjeruara” me “kompetenca të shtuara.”

ANEKSI II TË DREJTAT E KOMUNITETEVE DHE Pjesëtarëve të tyre

Neni 3 Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre

3.1(k) Shtimi i klauzolave të reja (në italike):

“E drejta për të krijuar dhe përdorur mediat e tyre vetanake, përfshirë ofrimin e informatave në gjuhën e tyre përmes, në mes tjerash, gazetat ditore dhe agjensione elektronike të lajmeve, dhe përdorimi i një numri të frekuencave të rezervuara për mediat elektronike në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. Kosova do të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar një plan ndërkombëtar të frekuencave që do t'i mundësojë Komunitet Serb të Kosovës qasje në një kanal të pavarur televiziv në gjuhën serbe me licencë mbarë-kosovare.”

ANEKSI III DECENTRALIZIMI

Neni 2 Legjislacioni i Kosovës për Vetëqeverisje Lokale

2.3 Shtim i një klauzole të re në fund (në italice): “Kosova do të nxjerrë legjislacionin themelor, në pajtim me parimet e përcaktuara në këtë Aneks, në mënyrë që të sigurohen trajtimi i barabartë proporcional dhe standardet minimale për të gjitha komunat, lidhur me rregullimin dhe menaxhimin e çështjeve publike që bien në përgjegjësinë e tyre, veçanërisht duke respektuar parimin e subsidiaritetit dhe duke kushtuar kujdes të duhur për qëndrueshmërinë fiskale të komunave dhe të qeverisë qendrore.

Neni 3 Kompetencat Komunale

3.1(j) Shtimi i një klauzole të re shpjeguese (në italice): “Ofrimi i shërbimeve familjare dhe shërbimeve tjera të mirëqenies sociale, siç janë kujdesi për personat e cenuseshëm, kujdestarimi, kujdesi ndaj fëmijëve, kujdesi ndaj të moshuarve, përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave të kujdesit, rekrutimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;”

Neni 4 Kompetencat e Shtuara Komunale

4.1 Zëvendësimi i kompetencave të “zgjeruara” me kompetenca të “shtuara” (në titull të Nenit dhe në tërë Nenin 4).

4.1.3(b) Zëvendësimi i “zgjedhjes dhe shkarkimit” me “emërimin”.

Neni 7 Arsimi

7.2.3 Ndryshim në fjalinë e dytë në lidhje me përbërjen e Bordit të Universitetit: “Universiteti do të ketë Bordin i cili do të përbëhet nga nëntë (9) anëtarë, prej të cilëve dy (2) do të emërohen nga komuna dhe pesë (5) do të zgjidhen nga radhët e fakultetit dhe / apo trupit studentor të Universitetit. Dy (2) anëtarët e mbetur do të emërohen sipas mënyrës që do të përcaktohet me statut të Universitetit.”

Neni 8 Financat Lokale

8.1 Zëvendësimi i “themelojnë buxhetet e tyre vetanake” me “do të kenë të drejtë të përcaktojnë strukturën dhe madhësinë e buxheteve të tyre.”

8.3 Heqja e fjalisë së fundit dhe futja në Nenin e ri 8.3.1.

8.3.1 Shtim i klauzolave të reja (në italice), dhe zhvendosja e klauzolës përfundimtare “do të përcaktohet përmes ligjit në pajtim me standardet ndërkombëtare” në Nenin e ri 8.3.3. “Formula e shpërndarjes së granteve në bllok *do të siguroj një nivel të arsyeshëm të stabilitetit të të ardhurave komunale, masë të duhur të barazimit në mes të komunave me baza të ndryshme tatimore, dhe ndarje adekuate të resurseve për komunitetet joshumicë në komunat përkatëse.*”

Shtim i Nenit të ri 8.3.2:

“8.3.2 Formula e shpërndarjes së granteve në bllok do të merr parasysh, *mes tjerash*, madhësinë fizike të komunës, numrin e banorëve, përfshirë numrin e pjesëtarëve të Komuniteteve që nuk janë në shumicë në komunë, dhe qasjen relative të banorëve të komunës në shërbime publike. ”

Shtim i Nenit të ri 8.3.3:

“Baza e granteve në bllok si përqindje e buxhetit total të Qeverisë dhe formula e shpërndarjes do të përcaktohet me ligj në pajtim me standardet ndërkombëtare.”

8.4 Zëvendësimi i kompetencave “të zgjeruara vetanake” me kompetenca “të shtuara”.

Neni 9 Bashkëpunimi Ndërkomunal

9.1.1 Zëvendësimi i kompetencave “të zgjeruara vetanake” me kompetenca “të shtuara”.

Neni 10 Bashkëpunimi me Institucionet në Serbi

10.1 Shtim i një klauzole të re në fjalinë e fundit (në italice): “Bashkëpunimi i tillë do të merr formën e ofrimit të asistencës financiare dhe teknike nga ana e institucioneve të Serbisë, *përfshirë personelin ekspertë dhe pajisjet*, në implementimin e kompetencave komunale.”

10.3 Zëvendësimi i “stafit” me “personelin ekspertë.”

Neni 11 Financimi i Aktiviteteve Komunale nga Republika e Serbisë

Zëvendësimi i “donacioneve” me “asistencë” çdo kund në këtë Nen.

SHTOJCË E ANEKSIT III PËRKUFIZIMI I KUFIJVE TË KOMUNAVE TË REJA

Kllokot/Vërboc

4 zonat kadastrave në vijim janë hequr nga komuna Kllokot/Vërboc:

ZK Letnica

ZK Shashar
ZK Vërnakollë
ZK Vërnez

ANEKSI V TRASHËGIMIA FETARE DHE KULTURORE

Neni 1 Emri, Organizimi i Brendshëm dhe Prona e Kishës Ortodokse Serbe

1.5 Shtim i frazës “rindërtimi i pronës”, në fjalinë e parë dhe zhvendosja e fjalisë së fundit në Nenin e ri 1.5.1.

Shtimi i Nenit të ri 1.5.2: “1.5.2 Kisha Ortodokse Serbe inkurajohet t’i ofrojë qasje publikut në objektet e veta për të nxitur dhe promovuar kuptimin dhe vlerësimin më të mirë të rëndësisë fetare, kulturore dhe historike të saj.”

Shtim i Nenit të ri 1.6: “1.6 Kosova nuk do ndalojë arbitrarisht hyrjen apo banimin në Kosovë të priftërinjve, kandidatëve për priftër, murgjve, murgeshave, personelit laik apo të ftuarve dhe pjesëtarëve të tjerë të Kishës Ortodokse Serbe.”

Shtim i Nenit të ri 1.7: “1.7 Kosova do të konsultohet me Kishën Ortodokse Serbe sa i përket promovimit të trashëgimisë Ortodokse Serbe për qëllime turistike, shkencore, arsimore apo për qëllime tjera publike. Ky promovim do të respektojë në plotësi traditat historike dhe fetare Serbe në Kosovë.”

Neni 2 Përkrahja Ekonomike dhe Përkrahja Tjetër

2.2 Zëvendësim i “verërat, konjak, mjalti dhe produktet tjera të bletës” me “dhe produkte tradicionale bujqësore” në fjalinë e parë. Shtimi i fjalës “bagëti” në fjalinë e fundit.

Neni 4 Zonat e Mbrojtura

4.1 Ndryshim i fjalisë së fundit për të përfshirë referencën mbi të drejtat pronësore: “Pa paragjykuar pronësinë e pronës që gjendet në Zonat e Mbrojtura, do të zbatohen kufizimet në vijim”

4.1.1 Ndryshimet në listën e aktiviteteve të ndaluara, si në vijim:

4.1.1(a) Shtim i “eksploatimi” i resurseve minerale, “pendave” dhe “rrugëve tranzite në vise rurale” tek lista e aktiviteteve të ndaluara.

4.1.1(b) Fshirja e Nenit të mëparshëm 4.1.1(b).

Neni i ri 4.1.1(b) / Neni i mëparshëm 4.1.1(c)
Shtimi i klauzolës së re në fund të fjalisë:
“apo ndotja e mjedisit.”

4.1.2 Disa ndryshime, siç vijon:

Ndryshimi i procedurës për sa i përket obligimit të komunës para ndërmarrjes së aktiviteteve të ndaluara nga “do të konsultohet me KOS” në “do të kërkojë pajtimin e KOS”, që do të përcillet me shtimin e një fjalisë të re në fund: “Nëse nuk arrihet marrëveshje, palët do t’ia referojnë këtë çështje KZM për shqyrtim, në pajtim me Nenin 5.4 të këtij Aneksi.”

Shtim i fusnotës të re 2: “Në rast të ndërmarrjes së aktiviteteve të tilla brenda Zonave të Mbrojtura të lokacioneve të shënuara në vijim, komuna gjegjëse do të konsultohet drejtpërdrejt me KZM: Monumenti Memorial i Gazimestanit; Kështjella Mesjetare e Zveçanit, qyteti mesjetar i Novobërdës, dhe Ura Mesjetare e Vojnoviqëve/Ura e Vjetër.”

4.1.2(a) Shtim i aktiviteteve vijuese të ndaluara: “strukturat apo godinat më të larta se manastiri / kisha / monumenti kulturor do të mbrohen,” ndërtimi i “rrugëve”, “hoteleve / moteleve,” dhe “pompave të benzinës dhe qendrave të riparimit të automjeteve, supermarketeve, klubeve të natës.”

4.1.4 Disa ndryshime, siç vijojnë:

Shtim i “Ura e vjetër” në emrin e Urës Mesjetare të Vojnoviqëve.

Zëvendësim në fusnotën 4 në “përfshinë Kompleksin Memorial të Isa Boletinit” me “është Zonë e Mbrojtur e përbashkët për Manastirin e Sokolicës dhe Kompleksit Memorial të Isa Boletinit. Komuna gjegjëse në përputhje me këtë, do të kërkojë miratimin e KOS dhe Administratës së Muzeut të Isa Boletinit për të gjitha aktivitetet e reja të parapara me Nenin 4.1.2. të këtij Aneksi.”

Ndryshim tek Zonat e Mbrojtura të lokacionit vijuese:
Eremitija me Kishë, Ularicë, Klinë

4.1.7 Zëvendësim i klauzolës së fundit “me Kishën e Shën Gjergjit” me “Kompleksin”, përcjellë nga shtimi i fusnotës së re 6: Kompleksi i Rezidencës Episkopike përfshin Rezidencën e Ipeshkvit, Katedralen e Shën Gjergjit, kishat e Shën Gjergjit (Runovik) dhe Shën Nikollës (Tutik).”

Neni 5 Këshilli Zbatues dhe Mbikëqyrës

5.4(d) Shtim i klauzolës së re në fund: “dhe të ofrojë rekomandime relevante për veprime të PCN-së, sipas nevojës.”

5.6 Fshirja e plotë e Nenit të mëparshëm 5.6.

Neni i ri 5.6 / Neni i mëparshëm 5.7

Heqja e klauzolës në fund të fjalisë: “ose me pasardhësin e tij, në çështjet e ruajtjes dhe rindërtimit të trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe”

ANEKSI VI BORXHI I JASHTËM

Zëvendësimi i “borxhi ndërkombëtar” me “borxhi i jashtëm” në tërë Aneksin, përfshirë edhe në titull.

Neni 1 Dispozitat e Përgjithshme

1.1 E rihartuar, si në vijim:

Heqja e fjalisë së dytë: “Borxhi ndërkombëtar i cili do të ndahet përfshin *ndër të tjera*, borxhin ndaj Bankës Botërore, dhe kreditorëve të klubit të Parisit dhe klubit të Londrës.”

Zëvendësimi i “duke pasur parasysh parimet e shfrytëzuara për caktimin e borxhit sovran në rast të suksesionit të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë”, me “bazuar në parimet vijuese, në marrëveshje me kreditorët relevantë: borxhi i alokuar i jashtëm do të bëhet detyrim i Kosovës në rastet kur përfituesi përfundimtar është i vendosur në Kosovë; borxhet e paalokuara të jashtme do t’i ndahen palëve sipas një çelësi proporcional që do të përcaktohet në marrëveshje mes palëve, në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FNM).”

Neni 3 Arbitrimi

3.1 Zëvendësimi i “një vit” me “gjashtë muaj” në fjalinë e parë.

3.3 Shtimi i “dhe merren përsipër nga” Kosova.

ANEKSI VII PRONA DHE ARKIVI

Neni 1 Ndërmarrjet Publike

1.1 Zëvendësimi i “ujit” me “furnizimi me ujë” në fjalinë e dytë. Shtimi i fjalisë në fund: “Kosova do të respektojë standardet Evropiane lidhur me menaxhimin e ujërave, mbeturinave dhe mbrojtjen mjedisore.”

1.2 Zëvendësimi i “Bashkimit Evropian” me “relevante ndërkombëtare” në fjalinë e parë.

Neni 2 Ndërmarrjet Shoqërore

2.1 Heqja e “institucionit pasardhës” nga Neni në tërësi, dhe shtimi i pikave vijuese në fusnotën 8:

- AKM do të finanohet nga Buxheti i Kosovës, burimet jashtëbuxhetore të ofruara nga donatorët dhe nga Fondet e Mirëbesimit të AKM, pas adresimit të të gjitha kërkesave valide të kreditorëve dhe sa i përket pronësisë;
- AKM do të marrë vendime mbi privatizimin apo likuidimin vetëm pasi të jetë konsultuar me zyrtarët nga komunat në të cilat janë të vendosura NSH relevante.
- Do të krijohen Komitete Shqyrtuese të cilat do të marrin në shqyrtim kërkesat ndaj veprimeve të AKM-së apo komiteteve likuiduese. Komiteti Shqyrtues do të nxjerrë rekomandim që do të jenë vendime përfundimtare të AKM-së. Këto vendime mund të sfidohen pranë Odës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështje të AKM-së;
- Komunitetet joshqiptare të Kosovës do të jenë të pranishme në Bord, komitete të likuidimit, dhe komitete shqyrtuese;
- Caktimi përfundimtar i pronësisë dhe shqyrtimi i kërkesave do të vazhdoj të bëhet përmes mekanizmit të Dhomës së Posaçme brenda Gjykatës Supreme, në pajtueshmëri me Nenin 3 të këtij Aneksi;

2.2 Shtimi i klauzolës në fund të fjalisë “përfaqësuesit vijues ndërkombëtarë”.

2.2(a) Fshirja e “ndërkombëtar” nga “tre (3) anëtarë *ndërkombëtarë*.”

2.2(d) Shtimi i një nën-paragrafi të ri në listën e të emëruarve nga PCN: “Një (1) anëtar, i cili gjithashtu do të jetë kryesues, në secilin Komitet Shqyrtues.”

Neni 4 Agjensioni Kosovar i Pronës

4.2(a), (c), dhe (d) fshirja e “ndërkombëtar” nga “anëtarët *ndërkombëtarë*” dhe “gjyqtarët *ndërkombëtarë*.”

Neni 5 Procesi i Shqyrtimit të Ankesave në AKP

Shtimi i Nenit të ri 5.2:

“5.2 Posedimi ilegal i pronës së paluajjtshme private nuk do t’i japë shfrytëzuesit të drejtën e pronësisë. Nëse parashtruesi i ankesës mund të vërtetojë se ai ose ajo nuk ka pasur qasje ndaj institucioneve relevante për të dorëzuar me kohë brenda afateve të parapara kërkesën për gjykim, kërkesa gjegjëse nuk do të konsiderohet si e papranueshme nga gjykata kompetente apo organi tjetër gjyqësor apo kuazi-gjyqësor kompetent.”

ANEKSI VIII SEKTORI I SIGURISË NË KOSOVË

Neni 5 Forca e Sigurisë e Kosovës

5.5 Ndryshimi i datës së aftësimit fillestar operacional nga brenda një viti nga “hyrja e kësaj Zgjidhjeje në fuqi” në brenda një viti nga “përfundimi i kësaj periudhe të tranzicionit, siç parashihet me Nenin 15 të kësaj Zgjidhjeje.”

Neni 6 Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK)

6.1 Shtimi i klauzolës “pasi që ka arritur qëllimet e parapara, përfshirë mundësimin e rimëkëmbjes së Kosovës pas konfliktit” në fjalinë e parë. Zëvendësimi i “shpërbërjes” me “shuarje” në fjalinë e dytë dhe të tretë. Ndryshimi i afateve kohore për shuarjen e TMK-së nga brenda një viti nga “hyrja e kësaj e Zgjidhjeje në fuqi” në brenda një viti nga “përfundimi i periudhës së tranzicionit, siç parashihet me Nenin 15 të kësaj Marrëveshje.”

ANEKSI IX PËRFAQËSUESI CIVIL NDËRKOMBËTAR

Neni 2 Mandati dhe Autoriteti i Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar

2.3 Shtimi i “kontrollit kufitar” në listën e fushave në të cilat do ketë autoritet PSBE, në fjalinë e dytë.

2.3(a) Fshirja e “së bashku” nga “veprojnë *së bashku* me autoritetet e Kosovës”

2.3(e) Zëvendësimi i “në mbështetjen e” autoriteteve kompetente të Kosovës me “me” autoritetet kompetente të Kosovës.

Neni 3 Koordinimi me Akterët Ndërkombëtarë

3.2 Shtimi i dy fjalive të reja në fund:

“Misioni i OSBE-së dhe personelit i tij do të akordohen privilegjet dhe imunitetet siç janë specifikuar në Nenin 4.6 të këtij Aneksi. Kosova do t’i mundësoj tërë asistencën e adekuate Misionit të OSBE-së, që është e nevojshme për të kryer në mënyrë efikase dhe efektive të gjitha detyrat e veta, përfshirë edhe ofrimin e përkrahjes logjistike dhe administrative sipas nevojës.”

Neni 4 Struktura / Angazhimi i Stafit në Zyrën e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar

4.6(b) Shtimi i “si dhe profesionistëve ndërkombëtarë që emërohen nga PCN, në pajtim me autoritetin e tij/saj të përcaktuara me këtë Zgjidhje” në listën e personelit ndërkombëtar të cilëve do t’i akordohen privilegje dhe imunitet.

ANEKSI XI PRANIA USHTARAKE NDËRKOMBËTARE

Neni 1 Objektivat

Zhvendosja e Nenit të mëparshëm 1.3 tek Neni i ri 1.9, dhe zëvendësimi i “PUN” me “NATO” në fjalinë e parë.

Shtimi i Nenit të ri 1.4:

1.4 PUN, në konsultim me PCN dhe Kosovën, do të ketë autoritet ekzekutiv mbi TMK-në, dhe do të vendosë mbi afatin kohor të shuarjes së TMK-së, siç përcaktohet në Nenin 6 të Aneksit VIII të kësaj Marrëveshje.”

ANEKSI XII AGJENDA LEGJISLATIVE

Neni 1 Legjislacioni që duhet të aprovohet formalisht gjatë periudhës së tranzicionit

Në titullin e Nenit të zëvendësohet “adoptohet” me “aprovohet formalisht”.

Shtimi i klauzolës “apo amendamenteve të tyre” në fund të paragrafit preambular.

Neni 2 Legjislacioni që duhet të aprovohet formalisht gjatë periudhës së tranzicionit apo që duhet të miratohet pas saj

Zëvendësimi i “të adoptohet gjatë apo pas” me “formalisht aprovohet gjatë apo miratohet pas” në titullin e Nenit.

Shtimi i klauzolës “apo amendamenteve të tyre” në fund të paragrafit preambular.

2.3 Zëvendësimi i “Ligjin e Aviacionit Civil me” me “Legjislacionin për themelimin e Autoritetit të Aviacionit Civil.”

2.5 Zëvendësimi i “Ligjin” me “Legjislacionin.”

2.8 Zëvendësimi i “Ligjin mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës” me “Ligjin mbi Shërbimin në Forcën e Sigurisë të Kosovës.”

2.9 Zëvendësimi i “Ligjin mbi Shërbimin Policor të Kosovës” me “Ligjin mbi Shërbimin në Forcën Policore të Kosovës.”